

IMPORT

Gjithçka që duhet të dini rreth importit.

Importi është transferimi i mallrave përmes kufijve shtetërorë, nga një burim i huaj.

Ai që kryen importimin quhet importues. Mallrat hyjnë/dalin në/nga territori doganor shqiptar nga/në një vend të huaj në rrugë:

Tokësore: Mallrat i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore që nga çasti i hyrjes në territorin shqiptar. Këto mallra duhet të dërgohen pa humbur kohë nga personi që i transporton ato:

- a) në zyrën doganore të caktuar nga autoritetet doganore ose në cilindo vend tjetër të caktuar ose miratuar prej tyre; ose
- b) në një zonë të lirë, nëse mallrat duhen të futen në atë zonë të lirë drejtpërsëdrejti me rrugë ujore, ajrore ose tokësore.

Rrugë ajrore të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse për trafikun ndërkombëtar, dhe mund të ulen e të ngrihen nga aeroportet ndërkombëtare të miratuara për trafik ajror me vendet e huaja.

Mjetet lundruese, të cilat transportojnë mallra që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe që lundrojnë në zonën doganore kufitare në det, liqene e lumenj të lundrueshëm, duhet të kenë në bord manifestin e mallrave.

Hekurudhore, e cila lejohet vetëm nepërmjet Shoqërise hekurudhore që pranon të fusë në territorin doganor mallra të shoqëruara me një dokument dorëzimi, dhe është organi përgjegjës për kryerjen e formaliteteve doganore përkatëse.

Po pyesni si po vjen porosia juaj nga jashtë? Ndiqni gjithë procesin.



VENDI I DEKLARIMIT DOGANOR

Dërgesa e porositur arrin në vende të caktuara të deklarimit për mallrat dhe pastrimin e tyre doganor - zyra doganore Postë, ose nëse arrin me transport ajror - zyra doganore, Rinas Tiranë.

DEKLARATA DOGANORE

Dërgesa merret në kujdes nga kompanitë që kryejnë dorëzim të shpejtë ose të zakonshëm - bazuar në të dhënat e deklaruara në dërgesë, përcaktohet nëse dërgesa është e nënshtroar doganave të importit ose është përjashtuar nga doganat dhe detyrimet e importit.

Dërgesat me një vlerë prej 22 eurosh (përfshirë kostot e transportit) lirohen menjëherë pas mbërritjes së dërgesës; nuk ka detyrim për të paraqitur një deklaratë doganore për to.

Për të gjitha dërgesat e tjera që kanë një vlerë mbi 22 euro (së bashku me kostot e transportit), ka një detyrim për të paraqitur një deklaratë doganore në formë të shkruar.

Kjo deklaratë mund të paraqitet nga transportuesi i dërgesës (posta ose posta e shpejtë) ose nga një agjent tjetër doganor. Gjithashtu mund të paraqitet nga një person fizik që merr dërgesën.

Kjo është çështje zgjedhjeje për importuesin (person juridik ose fizik) - ai duhet të vendosë vetë kush do të paraqesë deklaratën doganore.

Një nga mënyrat më të lehta të përcaktuara nga Administrata Doganore është paraqitja e një deklarate të thjeshtuar doganore nga importuesi duke plotësuar kushtet e mëposhtme:

Vlera e dërgesës (së bashku me kostot e transportit) nuk duhet të kalojë një shumë prej 800 eurosh në dhe një masë neto deri në 1,000 kg. Kjo është mënyra më e thjeshtë për pastrimin doganor të dërgesave që vijnë nga importi.

Nëse këto kushte nuk përmbushen, është e detyrueshme të paraqitet një deklaratë doganore në një procedurë të rregullt doganore. Kjo deklaratë mund të paraqitet nga importuesi (individ ose ent juridik), agjenti doganor - komisioner i mallrave, ose nga posta ose posta e shpejtë.

Ky lloj deklarate paraqitet vetëm në formë elektronike, pa letër për të gjitha dërgesat që përmbajnë mallra me natyrë tregtare, vlera e të cilëve është 450 euro veçanërisht: për mallrat me natyrë tregtare që janë pjesë e një serie të rregullt të dërgesave të ngjashme, për mallrat që janë nën kufizime, ndalime dhe formalitete të tjera të importit. Nëse kalon vlerën 450 euro atëherë për importin e tij duhet të jetë një kompani me NIPT, nuk mund ta realizojë dot një individ.



DOKUMENTACIONI

Shpesh, nga vendi ku porositet dërgesa, e shënojnë atë me një deklaratë që thotë se çfarë përmban, vlerën e saj dhe nga vjen. Kjo deklaratë është provë e vlefshme që përshkruan mallrat e porositur.

Nëse kërkohet dokumentacion tjetër, personi përgjegjës nga zyra doganore kontakton marrësin. Nëse ai nuk ofron të dhënat e nevojshme, vlera për të cilën duhet të pastrohet porosia llogaritet nga zyrtarët doganorë.

Nëse ai nuk pajtohet me vlerën e përcaktuar, ai ka të drejtën të paraqesë një kundërshtim për të.

Nëse një dërgesë dërgohet nga një person te një tjetër, dërguesi duhet të jetë i kujdesshëm të tregojë vlerën e mallrave, për të përcaktuar më lehtë nëse është nënshtroar pastrimit të rregullt doganor dhe pagesës së detyrimeve.

KOSTO SHITESË

Kostot që përfshihen në vlerën për të cilën një porosi duhet të nënshtrohet doganave përfshijnë kostot e postës që ndodhin jashtë Shqipërisë.

Kjo do të thotë nëse porosia është 50 euro, dhe posta për të arritur kushton 10 euro, vlera totale e porosisë është 60 euro.

Vlera doganore nuk përfshin kostot e tjera shtesë të mundshme që lindin në vendin tonë, të cilat llogariten dhe tarifohen posta publike e Shqipërisë dhe drejtoria e doganës.

Pas përcaktimit të vlerës doganore të dërgesës, zyrtarët doganorë llogarisin sasinë shtesë të detyrimeve që duhet të dërgohen.

Nëse vlera doganore e dërgesës është më pak se 22 euro, ajo është përjashtuar nga doganat dhe TVSH-ja. Kjo nuk vlen nëse dërgesa është një pije alkoolike, produkt duhani, parfum.

Nëse vlera doganore e dërgesës është mbi 22 euro, atëherë duhet të paguhen detyrimet e importit, dmth. doganat dhe TVSH-ja. Në këtë rast, paguhen kostot shtesë për trajtim dhe manipulim, të cilat dërgohen nga dega e doganës Rinas dhe posta e shqipërisë.

Këto kosto për trajtim dhe manipulim shpesh ngarkohen për dërgesa që janë përjashtuar nga pagesa e detyrimeve doganore dhe TVSH-së në importim, dhe qytetarët shpesh mendojnë se ato janë detyrime doganore.

*Kjo vlen vetëm nëse dërgesa është dërguar nga një ent juridik, dhe nuk vlen nëse dërgesa është marrë nga një person tjetër fizik.



ARRITJA E DËRGESËS

Në momentin kur dërgesa arrin në territorin e Shqipërisë derisa të përcaktohet trajtimi me të, ajo është nën mbikëqyrje doganore dhe trajtohet si mallra të ruajtura përkohësisht në një zyrë doganore.

Pas përfundimit të gjithë procesit, dërgesa arrin në postë dhe ju do të njoftoheni që të shkoni ta tërhiqni atë në pikën më të afërt!

